



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 891/4 Prot.

Tiranë, më 18 / 09 / 2018

V E N D I M

Nr. 180 , Datë 18 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. 91, datë 20.06.2018, të paraqitur nga E.Gj kundër Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, Tiranë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se: *“Është rikonfirmuar në pozicionin e punës si audit pas miratimit të strukturës së re me Vendimin nr.334, datë 30.04.2018. Në datë 08.06.2018 është njoftuar nga punëdhënësi për zhvillimin e një takimi për të diskutuar lidhur me mundësinë e zgjidhjes së kontratës së punës. Këshilli Mbikqyrës është organi kompetent që emëron apo shkarkon auditin e brendshëm dhe punëdhënësi nuk i ka vënë në dispozicion një urdhër të firmosur dhe të protokolluar nga Këshilli Mbikqyrës për largimin e saj nga puna. Gjatë gjithë periudhës ka kryer me përkushtim punën dhe nuk ka pasur asnjë masë disiplinore nga eprori apo auditit i KLSH-s. Drejtori që në takimin e parë e ka pyetur për origjinën duke e etiketuar dhe për bindjet politike”*.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në pozicionin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

¹ Anëtare e subjektit politik: “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën me nr.891/1, datë 02.07.2018 është njoftuar Rezidenca Studentore Universitare, Nr.2 dhe i është kërkuar informacion lidhur me pretendimet e ngritura nga shtetasja E.Gj.

Me shkresën nr.645/1, datë 09.07.2018 Rezidenca Studentore Universitare nr.2, informon Komisionerin se: “E.Gj është emëruar pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentit nr.2” sh.a me Vendimin nr.37, datë 16.11.2015 të Këshillit të Mbikëqyrjes, në pozicionin si specialist auditi dhe në zbatim të këtij vendimi është emëruar nga Administratori me shkresën nr.417/1, datë 16.11.2015. Në bazën ligjore të vendimit të emërimit është vendosur Udhëzimi nr.318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore” i METE, udhëzim i cili në pikën 6 të Kreut IV “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës” një nga kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës është emërimi i Kryetarit të Njesisë së Auditimit, dhe jo emërimi i specialistit të njesisë së auditimit. Pra në këtë kontekst, emërimi i E.Gj nga Këshilli Mbikëqyrës nuk është i drejtë, pasi Këshilli Mbikëqyrës i ka kaluar kompetencat e tij. Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në Vendimin nr.76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, Sektori i Auditit në Rezidencën Studentore Universitare nr.2 është pjesë e strukturës së shoqërisë dhe ka varësi direkte nga Administratori”. Ndërsa, lidhur me pretendimin e E.Gj se është konfirmuar në pozicionin e punës me Vendimin nr.334, datë 30.04.2018 dhe më pas i ka filluar procedura e zgjidhjes së kontratës pa shkak, Rezidenca Studentore Universitare nr.2 informon se: “Me Vendimin nr.76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar struktura e re e institucionit dhe direkt nga titullari ka filluar implementimi i saj. Implementimi i strukturës është

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

bërë duke rikonfirmuar gjithë pozicionet ekzistuese me strukturën e re dhe pas përfundimit të implementimit, filluan procedurat ligjore të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për ato pozicione pune që u suprimuan. Me Memon nr.122, datë 01.06.2018, Përgjegjësja e Sektorit të Burimeve Njerëzore, ka propozuar fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës pasi ka evidentuar mosplotësimin e kriterit të punësimit të E.Gj e cila ka qenë në një marrëdhënie pune afërsisht prej 3 vitesh dhe nuk është pajisur me Liçensën e Auditit, siç parashikon pika 2/ç e nenit 11 të ligjit 114/2015 “Për audituesit e brendshëm në sektorin publik”. Të ndodhur para këtij fakti të konstatuar, është nisur procedura e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës konform ligjit me punonjësen E.Gj”.

2. Me shkresën nr.1061, datë 26.07.2018 është kërkuar informacion shtesë nga subjekti, Rezidenca Studentore Universitare, Nr.2.

Me shkresën nr.645/3, datë 13.08.2018, Rezidenca Studentore Universitare nr.2, informon Komisionerin se: “Pas emërimit, E.Gj ka patur gjithë kohën e duhur për tu pajisur me Liçensën e Auditit dhe në asnjë moment nuk ka bërë përpjekje për aplikim në instancat kompetente, dhe në datë 16.11.2017 i ka mbaruar afati ligjor që përcakton ligjshmërinë e vazhdimësisë së punës si audit i brendshëm. Punonjësja M.H me detyrë Përgjegjëse Auditit në Rezidencën Studentore Universitare nr.2, është emëruar në detyrën e auditit në datën 01.09.2002 ka mbushur moshën e pensionit në datë 26.05.2018 dhe sipas ligjit të sigurimeve shoqërore del në pension në datë 26.03.2019. Punonjësja ka aplikuar disa herë për të marrë certifikatën si audituese e brendshme por kërkesa nuk i është miratuar, pasi në fillim janë pajisur me certifikatë punonjësit e auditit të institucioneve me rëndësi të veçantë. Me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të “Rezidencës Studentore Universitare nr.2”, me strukturën e miratuar për vitin 2018, si për të gjitha pozicionet e tjera dhe për pozicionin e auditit është kërkuar, plotësimi i kriterëve sipas ligjit 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, por në rastin e punonjësës M.H është bërë përjashtim mbasi është punonjësja më e vjetër dhe del në pension. Punonjësi E.P është emëruar në datë 10.05.2018, në pozicionin si Specialist Auditit. E.P është emëruar konform nenit 11 të ligjit 114/2015, pasi ka arsimin përkatës dhe ka mbi tre vjet punë si ekonomist dhe është shpallur fitues në listën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si kandidat për auditues i brendshëm për ndjekjen e procesit të certifikimit, sezoni 2018-2019”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankueses nga Rezidenca Studentore Universitare nr.2 Tiranë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, E.Gj ka filluar punë pranë Rezidencës Studentore Universitare nr.2, Tiranë me datë 16.11.2015³ në pozicionin “Specialist auditit” në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve nr.2” Tiranë. Kjo marrëdhënie pune ka

³ Referuar Vendimit nr.37, datë 16.11.2016 të Këshillit të Mbikëqyrjes të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve nr.2” dhe shkresës nr.417/1, datë 16.11.2015 të Administratorit mbi emërimin në detyrë të E.Gj.

zgatur deri në datën 18.06.2018, datë kur Rezidenca Studentore Universitare nr.2, Tiranë ka përfunduar marrëdhënien e punës me E.Gj, për shkak të moscertifikimit të saj si auditues i brendshëm⁴. Në dosjen e ankueses është depozituar dokumentacioni provues lidhur me kualifikimin e saj: - Diplomë nr.14130, e Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, në degën, Administrim Biznesi, në profilin: Menaxhim Biznesi si dhe përvoja e punës si specialiste finance në Kompaninë e Sigurimeve Sigal Life, Tiranë për periudhën 2005-31.03.2015⁵.

Lidhur me sa më sipër konstatohet se: Referuar Ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe specifikisht nenit 11 të tij, përcaktohet se:

“1. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga auditues të brendshëm, që punësohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, si dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës në njësitë publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

2. Përveç kushteve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme si më poshtë:

a) të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;

b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm;

c) audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm;

ç) punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t’i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm”, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji”.

Komisioneri, pas këqyrjes dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga palët në proces, vlerëson se subjekti ankues nuk i përmbush kriteret e kërkuara nga Ligji nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, pasi nuk është e pajisur me certifikatën si audituese e brendshme.

Në interpretim të parashikimeve të nenit 11, të këtij ligji, në tërësinë e tij, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji, pasi përmbush:

⁴ Në zbatim të Vendimit nr.603/2, datë 18.06.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, me motivacionin, për mosplotësim të kriterëve të punësimit të parashikuara në nenin 11 të ligjit 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

⁵ Referuar Curriculum Vitae të E.Gj vënë në dispozicion me shkresën nr.645/1, datë 09.07.2018.

Së pari, kriterin arsimor, sipas të cilit punonjësi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike.

Së dyti, kriterin e përvojës në profesion, pasi ka përvojë punë mbi 3 vjet në profesion si ekonomiste.

Së treti, nuk përmbush kriterin që brenda dy viteve të para të punës punonjësi duhet t'i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si "Auditues i brendshëm".

Në lidhje me pretendimin e ankueses se dhe specialisti i auditit i emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm nuk zotëron certifikatën e auditit, Komisioneri vlerëson se:

- Referuar Vendimit nr.76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë "Trajtimi i Studentëve nr.2" Tiranë, mbi miratimin e strukturës së shoqërisë për vitin 2018, konstatohet se pozicioni i punës për Specialist Auditit ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm dhe emërimi i tij është bërë nga drejtori.
- Ligji nr.114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" ka përcaktuar Ministrinë e Financave dhe Komisionin e Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm pranë saj, si strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm.
- Në kreun VI, "Kriteret e kualifikimit të audituesit të brendshëm", neni 19, pika 2 e tij përcaktojnë se: "Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë individët e klasifikuar në shkronjën "ç", të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji".

Në zbatim të legjislacionit sa më sipër cituar dhe referuar listës përfundimtare të kandidatëve për auditues të brendshëm të shpallur fitues për ndjekjen e procesit të certifikimit, sezoni 2018-2019⁶ nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, verifikohet se E.P është kualifikuar për të ndjekur procesin e certifikimit si auditues i brendshëm.

Në konkludim të kësaj, Komisioneri vlerëson se punonjësi E.P, në përputhje me parashikimet ligjore të germës "ç", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr.114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", është në ndjekje të rregullt të kursit për certifikimin e tij si auditues i brendshëm, gjatë sezonit 2018-2019 dhe plotëson kriterin për t'iu nënshtuar procedurës së certifikimit.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga punëdhënësi, Rezidenca Studentore Universitare nr.2, Tiranë, lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjes politike, vlerësohet se E.Gj nuk është larguar nga puna për shkak të bindjes së saj politike por i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për mosplotësim të kriterëve ligjore për pozicionin e punës si auditues i brendshëm në zbatim të kërkesave të nenit 11/2/ç të ligjit nr.114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e punëdhënësit, Rezidenca Studentore Universitare nr.2, Tiranë në drejtim të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës

⁶ Referuar dokumentacionit të dërguar me shkresën nr.645/3, datë 13.08.2018 nga Rezidenca Studentore Universitare nr.2, Tiranë.

me E.Gj nuk kanë qenë diskriminuese, pasi përmbushja e kriterëve ligjore për punësimin si auditues të brendshëm nuk përbën trajtim më pak të favorshëm, krahasuar me personat e tjerë që i përmbushin këto kriterë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases E.Gj nga ana e shoqërisë: Rezidenca Studentore Universitare nr.2, Tiranë, për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(shkaku: bindja politike)

(fusha: punësim)